

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

7.03.2025

Ora 14:06

RENDI I DITËS

*Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimet me nr. 47, nr.55 të
organizatës qendra “Qëndresa Qytetare” dhe denoncimin me nr. 49, të Partisë
Demokratike.*

*Për shqyrtimin administrativ të çështjeve të mbartura bazuar në denoncimin me
nr. 12, të Institutit të Studimeve Politike, denoncimet me nr. 22, nr.23, nr. 28 të
Partisë Demokratike dhe shqyrtimin e denoncimit me nr. 24, të Koalicionit për
Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.*

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj

Parti Politike: Partia Demokratike (z. F. Nuri)

Të tjerë: KRIIK, “Qëndresa Qytetare”, Instituti i Studimeve
Politike, Kuvendi, Kryeministria, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Kopshteve dhe
Çerdheve

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite për shqyrtim rishtas çështjet në vijim: denoncimin me nr. 47, të organizatës qendra “Qëndresa Qytetare”, denoncimin me nr. 49, të Partisë Demokratike, denoncimin me nr. 55, po të organizatës qendra “Qëndresa Qytetare”. Ndërkohë të mbartura kemi: shqyrtimin administrativ të denoncimin me nr. 12, të Institutit të Studimeve Politike, denoncimin me nr. 22, të Partisë Demokratike, denoncimin me nr. 23 dhe 28, po të Partisë Demokratike dhe shqyrtimin e denoncimin me nr. 24, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 47, të organizatës “Qëndresa Qytetare”. Po Pavlina.

Znj. P. Doçaj: Denoncimi me 47 të regjistrit, denoncues është “Qëndresa Qytetare”, subjekt i denoncuar janë: zonja Elisa Spiropali, zoti Bukurosh Maçi, zoti Afrim Tafani, zoti Gledian Llataj, zoti Ermal Dredha, zoti Vangjel Tavo. Objekti i denoncimit ka të bëjë me konstatimin e përdorimit të burimeve publike dhe pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me faktin që në kuadër të programit “Kuvendi kuvendon”, Kryetarja e Kuvendit ka zhvilluar disa aktivitete, në bashkitë e sipër cituara, në të tria rastet, të të tria bashkive denoncuesi pretendon se kanë vizituar institucione të arsimit parauniversitar, më konkretisht në shkollat “Meleq Gjozi”, “Zihni Magani” dhe “Spiro Gjikhuri”. Sipas denoncimit të denoncimeve publike është ndërprerë procesi mësimor, me qëllim pjesëmarrjen dhe dërgesën e Kryetares së Kuvendit, e cila në fjalën e saj ka përdorur propagandë politike dhe konkretisht terma si: “votuesit tanë”, “për inat të Edi Ramës dhe qeverisë nuk mund t’i bie Shqipërisë”, “për reformën në drejtësi e kemi bërë me kosto të madhe politike” etj. Nga ana jonë është proceduar me fillimin e hetimit administrativ në datën 3.03.2025, kemi administruar pretendimet e palëve në proces, të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët në pretendimet e tyre theksojnë se kanë analizuar vetëm misionin e tyre si institucion, që ushtron një sovranitet të popullit dhe ka detyrim të edukojë publikun mbi demokracinë përfaqësuese dhe të nxisë angazhimin e tyre në vendimmarrje, pra që nuk kanë të bëjnë me thirrje politike. Në datën 3.03.2025 kemi administruar edhe pretendimet e Bashkisë Vlorë, edhe këta theksojnë që ka qenë një aktivitet në kuadër të zbatimit të planit strategjik të vitit 2022-2025 dhe nuk janë aktivitete të cilat kanë pasur si qëllim veprimtari politike, po kështu dhe Bashkia Elbasan, të njëjtën gjë ka theksuar, ka theksuar se e ka deklaruar si

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

veprimtari publike në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe si aktivitet nuk ka të zhvilluar aktivitet me ngjyra politike dhe Bashkia Peqin të njëjtën gjë dhe Bashkia Belsh po të njëjtën gjë, pra që takimet nuk kanë pasur propagandë politike. Janë thirrur si palë për ditën e sotme, në seancë është prezent vetëm Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesi i Kryetarit të Bashkisë Peqin.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Paraprakisht përfaqësuesi i “Qëndresës”, nëse do të shtoni diçka më shumë, se çfarë keni paraqitur në denoncim? Po.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Faleminderit i nderuar! Përpara se të vijoj me parashtrimin në lidhje me denoncimin tonë, duke mbajtur në konsideratë dhe prapësimet e Kuvendit do të dëshiroja të bëja tre pyetje ndaj përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë.

Z. I. Celibashi: Para se të filloni pyetjet, keni ndonjë gjë për të shtuar se pastaj i japim fjalën atyre për të paraqitur ato...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Do të doja paraprakisht që të bënim pyetjet...

Z. I. Celibashi: Dakord, në rregull.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: ...baza e ankimit dhe më saktë denoncimi ynë del shumë i qartë nëse përgjigje marrin këto tri pyetje. Atëherë “Qëndresa Qytetare” ka bërë tre, një kërkesë për informacion edhe në të njëjtën

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

kohë në prapësimet e Kuvendit dhe në përgjigjen e Kuvendit, në shkresën me numër protokolli 600/1, datë 21.02.2025, po dhe në shkresën e prapësimi me numër protokolli 894/1, Kuvendi shprehet se iniciativa “Kuvendojmë për Shqipërinë” është një...

Z. I. Celibashi: Shkresa që ju keni dërguar, kërkesë për informacion ?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: ...po një kërkesë paraprake për informacion dhe në të njëjtën kohë kemi marrë dhe prapësime kur kemi bërë denoncimin. Shprehet se: “Iniciativa “Kuvendojmë për Shqipërinë” është një iniciativë e Kryetares së Kuvendit si figurë institucionale që garanton funksionimin e Kuvendit përtej palëve dhe anshmërive politike”. Në të njëjtën kohë në prapësime citohet se: “Parimet bazë ku mbështetet veprimtaria e shërbimit dhe edukimit qytetar të Kuvendit të Shqipërisë”, iniciativë e të cilit besohet sipas Kuvendit është kjo janë “paanshmëria dhe transparenca”, “gjithëpërfshirja dhe besueshmëria”. Pyetjet që kam së pari për Kuvendin e Shqipërisë është nëse kjo është një nismë e Kryetares së Kuvendit që garanton paanshmërinë institucionale, pavarësinë, depolitizimin e Kuvendit dhe faktin që kemi të bëjmë me pushtete të ndara, pse Kryetarja e Kuvendit flet në emër të qeverisë në këto aktivitete? Citoj këtu: “Të jesh e bindur nuk ka qeveri në botë që nuk do të donte t’i bënte pensionet dhe rrogat, përfitimet të gjitha maksimale, jo vetëm për vota dhe për arsye elektorale por edhe pse do t’i jepnin kënaqësi të madhe vetes, por këmbët shtrij aq sa ke jorganin dhe vetëm regjimet që janë të papërgjegjshme bëjnë lëshime të mëdha financiare”, cili është roli i Kryetares së Kuvendit për sa i takon rritjes së pagave, kur këto janë vendime që merren nga pushteti ekzekutiv? Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë përfaqësuesit e Kuvendit janë këtu, në lidhje me denoncimin në tërësi por dhe me pyetjet...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Dhe disa pyetje të tjera shtesë por do të doja që t’i trajtonim ose mund t’i bëj të gjitha bashkë pyetjet?

Z. I. Celibashi: Po më mirë ndoshta sepse dhe ata kanë mundësinë...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Dakord. Së dyti nëse është një iniciativë transparente dhe gjithëpërfshirëse, si janë njoftuar këto takime për pjesëmarrësit duke qenë se në faqen e Kuvendit, në asnjë rrjet social po edhe në faqen zyrtare të Kuvendit nuk rezulton që të ketë ndonjë takim në kuadër të kësaj nismës “Kuvendojmë për Shqipërinë”, zëri i popullit? Së treti, nëse është një iniciativë jo politike, e paanshme, përtej palëve, duke qenë se mbajmë në konsideratë dhe prapësimet tuaja, ku theksohet që roli i zotit Bledi Çuçi është në cilësinë e Nënkryetarit të Kuvendit, pse është thirrur vetëm njëri nga zëvendëskryetarët e Kuvendit, ndërkohë që Kuvendi ka dy nënkryetarë, që përfaqësojnë shumicën parlamentare dhe pakicën parlamentare? Nëse është ftuar zoti Agron Gjekmarkaj, a mund të na vendosen në dispozicion një ftesë e kësaj natyre? Së katërti ndjesë, deputeti përfiton dieta ditore për gjithë shërbimet e tij jashtë vendit, brenda vendit, sikundërse provohet në fakt dhe nga disa të dhëna që ne kemi nxjerrë ditën e sotme nga Thesari i Shtetit, rezultojnë se janë bërë pagesa për përballimin e shpenzimeve dhe dietave ditore të stafit të Kuvendit po dhe të Kryetares së Kuvendit. Nuk është problem që të përballohen shpenzimet sepse është një detyrim ligjor, megjithatë Kryetarja e Kuvendit ka marrë dieta për të zhvilluar edhe takime elektorale me deputetë të Partisë Socialiste, siç është ky

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

takimi këtu ku janë të gjithë deputetët e Partisë Socialiste dhe ky aktivitet zhvillohet rreth orës 16.00, në kohën e drekës, në të cilën ne kemi dyshime që mund të jetë përballuar me shpenzimet e Kuvendit, megjithatë në këto momente nuk disponojmë ndonjë provë shtesë. Këto ishin pyetjet tona, faleminderit! Në vijim do të vijojmë me prapësimet.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ndoshta dhe me mirëkuptimin tuaj për ato elementë të tjerë të cilët ju i prezantuat si shkelje, i pretenduat si shkelje, ndoshta mund të jenë objekt i një shqyrtimi tjetër dhe do të propozoja që të ngelemi tek, apo bëhet fjalë për aktivitetin e...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: I nderuar, bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet.

Z. I. Celibashi: Të të njëjtës ditë?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Për të gjitha aktivitetet që ne kemi denoncuar “Kuvendojmë për Shqipërinë” të mbajtur në qarkun e Elbasanit dhe për aktivitetin “Kuvendojmë për Shqipërinë” në qarkun e Himarës.

Z. I. Celibashi: Dakord. Nëse janë për të njëjtën.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Të gjitha këto shpenzime, të gjitha këto pyetje lidhen vetëm me këtë objekt denoncimi sepse nga verifikimet tona rezulton që Kuvendi i Shqipërisë ka shpërdoruar fonde publike për të zhvilluar takime, mbështetje për Partinë Socialiste. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Dakord jemi në rregull. Mirë, atëherë përfaqësuesit e Kuvendit në lidhje me denoncimin dhe përgjigje për pyetjet nëse vlerësoni. Ju lutem!

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Përshëndetje Glen Mebelli, këshilltar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit dhe person përgjegjës për raportimin e aktiviteteve me karakter publik sipas nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Kuvendi i Shqipërisë është njoftuar mbi fillimin e hetimit administrativ pas denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare” në lidhje me aktivitetet e iniciativës “Kuvendojmë për Shqipërinë”, pjesë e së cilës është programi “Kuvendon”. Lidhur me këto pretendime të subjektit denoncues, ne kemi dërguar me datë 4.03.2025 prapësimet me shkrim. Marrë parasysh se për këto aktivitete dhe programe, si Kuvend jemi shprehur, po ashtu dhe gjatë hetimit administrativ nr.12, Instituti i Studimeve Politike. Si fillim duhet të ritheksoj disa shpjegime për natyrën e aktiviteteve dhe më pas mund të adresoj 3 çështje apo pretendime të subjektit denoncues, që janë unike të këtij denoncimi nr. 47. Atëherë turi “Kuvendojmë për Shqipërinë” pjesë e së cilës është edhe programi “Kuvendon” janë aktivitete të Kuvendit të Shqipërisë, pjesë e detyrimeve institucionale në kuadër të edukimit qytetar. Kuvendi ka pjesë të misionit institucional të krijojë dhe të zbatojë programe, të cilat informojnë dhe edukojnë qytetarët në lidhje me demokracinë dhe qeverisjen, si dhe të nxisë qytetarët të jenë aktivë në veprimtarinë parlamentare. Këto programe Kuvendi i zbaton, jo përmes stafit politik po përmes Shërbimit të Edukimit Qytetar, që është një strukturë varësie e Institutit Parlamentar. Në këtë kuadër Shërbimi i Edukimit Qytetar zbaton një mori iniciativash, si ture, programe, aktivitete edukuese dhe informuese dhe deri më sot në zbatim të këtyre programeve Shërbimi, Kuvendi numëron mbi 18 000 vizita. Pikërisht turi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

“Kuvendojmë për Shqipërinë” dhe programi “Kuvendon” që është pjesë e tij, janë në të njëjtën linjë me këto qëllime, janë në linjë me qëllimet e parashikuara në rregulloren e Kuvendit lidhur me “Javën e gjelbër”. Ato bazohen gjithashtu në planin strategjik 2020-2025 të Kuvendit të Shqipërisë, fusha prioritare nr. 3, objektivat 1, 2 si dhe planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie dhe konkretisht aktiviteti 3.1.2, organizimi i takimeve periodike të qytetarëve me deputetët për të prezantuar veprimtarinë e Kuvendit. Programi “Kuvendon” është konceptuar dhe pilotuar që në shtator 2023, Kryetarja e Kuvendit, zonja Spiropali ka nisur në muajin shtator 2024 programin “Kuvendon”, fillimisht me një aktivitet në ambientet e Kuvendit me temë me të drejtën e informimit dhe transparencën. Më tej turi “Kuvendojmë për Shqipërinë” ka nisur në tetor 2024 nga Kryetarja e Kuvendit, pjesë e të cilit është edhe programi “Kuvendon” midis disa programeve të tjera, me qëllim për të bashkëbiseduar me qytetarët, për t’i informuar ata mbi nisma ligjore në interes të tyre, për të mbledhur opinione, për të mbledhur zgjidhje që ata propozojnë për projektligje të caktuara në të gjithë vendin. Që në prezantimin e kësaj nisme, iniciative është komunikuar dhe misioni i turit, është komunikuar synimi i tij për t’u realizuar potencialisht në të gjitha qytetet e Shqipërisë, për të promovuar dialogun midis qytetarëve dhe vendimmarrësve me qëllim përfundimtar zvogëlimin e hendekut mes qytetarit dhe institucionit ligjvënës, si dhe për të nxitur angazhimin më konstruktiv, për të kontribuar në fund të ditës në demokracinë pjesëmarrëse. Deri më sot turi “Kuvendojmë për Shqipërinë” i Kryetares është zhvilluar në qarqet e Beratit, Elbasanit dhe Vlorës. Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, neni 92 dhe të vendimit nr. 9/2020, të ndryshuar, të Komisionit Rregullator, Kuvendi ka raportuar mbi veprimtaritë me karakter publik të institucionit për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve, ku janë përfshirë dhe janë raportuar dhe aktivitete pjesë e këtij turi. Kjo për sa i përket

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

natyrës së turit dhe programit. Lidhur me tri çështjet që janë unike të këtij denoncimi, së pari mbi pretendimet për aktivitetet e datës 22.10.2024 në qarkun Berat, në fillim duam që të qartësojmë se aktivitetet e kësaj date, duke qenë se janë zhvilluar jashtë periudhës katër mujore para datës së zgjedhjeve nuk...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Ndjesë, duke qenë se dhe ju jeni referuar, ndoshta dhe për efekt të kohës, takimi i zhvilluar në qarkun e Beratit nuk është referuar ose më saktë nuk kemi pretenduar që ka shkelje në këtë takim, por e kemi përdorur për analogji, duke treguar që veprimtaria dhe axhenda përputhen, si për shembull në rastin e Beratit kemi një takim në drekë me deputetët e qarkut të Beratit dhe kryetarët e bashkive, në të njëjtën kohë e njëjta analogji zbatohet dhe për takimet e tjera, kështu që çështja është objekt i denoncimit.

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Pikërisht në këtë linjë po thosha, pavarësisht se nuk janë pjesë e shqyrtimit administrativ, pasi bien përtej datës, edhe për ne është e rëndësishme për të kuptuar fillësën e programit dhe për të qartësuar natyrën e vizitave në institucionet arsimore, ndaj e marrim në konsideratë dhe e konsiderojmë këtë të rëndësishme për t’u sqaruar në seancë publike, si para Komisionerit, si para organizatave të shoqërisë civile dhe para publikut. Për efekt qartësie dhe sqarimi të natyrës jo elektorale të vizitave të Kuvendit të Shqipërisë në institucionet arsimore. Konkretisht në këtë rast ka qenë shkolla 9-vjeçare “Meleq Gjozi” por është i njëjta ide, i njëjti koncept, zbatohet njëjtë sa herë Kuvendi hyn në një institucion arsimor. Konkretisht janë prezantuar dy programe të edukimit qytetar, që janë “Punishtja e demokracisë” dhe “Fjala ime”. Është e rëndësishme të kuptojmë nga kanë lindur këto programe? “Punishtja e demokracisë” është një program i Parlamentit Austrisë, i cili ka mbështetur dhe realizimin e tij në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Kuvendin e Shqipërisë. Ndër vite ky program ka tërhequr disa mijëra nxënës shkollash, duke e bërë Kuvendin një institucion të hapur, për një grupmoshë të re, për fëmijët dhe të rinjtë. Përfitimi i këtij programi është i dyfishtë, nga njëra anë në moshë të re, nxënësit dhe të rinjtë informohen mbi rolin e Kuvendit, mbi veprimtarinë e Kuvendit, mbi rëndësinë e angazhimit dhe nga ana tjetër Kuvendi dhe deputetët përfitojnë nga mendimet dhe këndvështrimet e të rinjve që më pas i përkthejnë në punën e tyre të përditshme. Ky program është zbatuar fillimisht në Kuvend përmes një projekti të financuar nga fondacioni YES dhe vazhdon të realizohet si përmes fondeve të Kuvendit, ashtu edhe në mbështetje të angazhimit të NDI përmes projektit të financuar nga qeveria zvicerane. Pse e theksoj këtë gjë? Për vetë faktin sepse përpara se të krijohej Shërbimi i Edukimit Qytetar si një drejtori më vete e dedikuar për realizimin e një detyrimi insitucional të Kuvendit nga çdo vlerësim ndërkombëtar, nga projekte të huaja, vihej në pah një mangësi e Kuvendit në rolin që do të duhej të luantë për edukimin qytetar dhe që në fakt nuk kishte kapacitetet dhe nuk e luante, ndaj në këtë ide janë, kanë filluar të implementohen, huazohen, krijohen programe të tilla me partnerë ndërkombëtarë dhe në fakt të nxitur prej tyre për të qenë të sinqertë. Gjithashtu dhe “Fjala ime” është po ashtu një program dinamik që synon të fuqizojë zërat e të rinjve dhe përdor produkte publicistike të fokusuara te tema e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për t’i aftësuar nxënësit të jenë më elokuentë në diskutime demokratike dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo për sa i përket çështjes së parë të natyrës pse Kuvendi i Shqipërisë hyn në institucione arsimore. Së dyti mbi pretendimet për aktivitetet e datës 28.01.2025, qarku Elbasan, që është pjesë e shqyrtimit administrativ, është pjesë e periudhës katër mujore. Të gjitha aktivitetet janë raportuar nga Kuvendi në kohë, janë lejuar për t’u zhvilluar, në këto aktivitete janë ngritur disa çështje nga qytetarët, si roli i Kuvendit përmes komisionit përgjegjës

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

në adresimin e sfidave lidhur me revulicionin teknologjik në arsim, transparenca e Kuvendit dhe njohja me nismat ligjore, nxitja e Kuvendit për shqyrtimin dhe ndërhyrjen në skemën e sigurimeve shoqërore, roli i grupeve informale të miqësisë në Kuvend për promovimin ndërsektorial të artit, roli i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese dhe nënkomisionin për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Kuvend, për të nxitur një model turizmi të qëndrueshëm e të tjerë. Lidhur me pretendimet e subjektit denocues se me shpenzimet e Kuvendit të Shqipërisë është mbuluar drekimi me deputetë të mazhorancës, si pjesë e programit zyrtar, duam të sqarojmë se kjo nuk ka ndodhur, asnjë fond i Kuvendit nuk është shpenzuar për kohën e pushimit të drekës mes aktiviteteve të turit dhe është e rëndësishme ta sqarojmë se axhenda e programit nuk ka parashikuar një drekë zyrtare dhe po e vendos drekimin si kohën e pushimit mes aktiviteteve në mënyrë që shërbimet e Kuvendit të kenë të qartë oraret e aktiviteteve, por nuk është pjesë e programit zyrtar dhe nuk mbulohet nga fondet e Kuvendit dhe kështu duke qenë se dreka nuk është mbuluar, nuk mendoj se mund të shqyrtojmë personat me të cilët Kryetari i Kuvendit ka drekuar privatisht dhe nuk mund të jetë objekt shqyrtimi para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për këtë është e qartë dhe nga çfarë kërkohet në program sepse programi njofton administratën e Kuvendit dhe shërbimet se çfarë ka nevojë për ta dhe në faqen e dytë specifikisht në mënyrë eksplicite thotë dhe kërkon shërbime të caktuara dhe në këtë rast janë: transporti i banerit me logon e programit “Kuvendon” me përmasa 3 metër me 6 metra, i lëvizshëm, vidio dhe montazh, transport për stafin shoqërore, staf mbështetës nga Shërbimi i Komunikimit, Shërbimi i Protokollit, Shërbimi i Edukimit Qytetar. Pra për sa kohë në këto pretendime eksplicite nuk është kërkuar shpenzim i drekës nuk ka sesi dhe administrata apo shërbimet e Kuvendit të kenë mbuluar një shërbim dreke, as nuk është kërkuar dhe as nuk është mbuluar. Së treti, në vijim të aktiviteteve të datës

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

11.02.2025 për qarkun Vlorë, po ashtu janë raportuar nga Kuvendi në kohë dhe janë lejuar për t'u zhvilluar, nuk do zgjerohemi së tepërmi në temat e diskutuara, duke qenë se jemi shprehur një herë në denoncimin nr. 12 që ka qenë po ashtu seancë publike. Një sqarim lidhur me takimin në Universitetin "Ismail Qemali" që nuk është zhvilluar për shkak të ndryshimeve të axhendës në minutën e fundit dhe aty ku duam të dalim më shumë është për të sqaruar disa citime që subjekti denoncues i ka pretenduar si me karakter elektorale. Fillimisht përdorimi i togfjalëshit "votuesit tanë" mendojmë që shkëputja nga fjalia nuk paraqet kontekstin e saktë sepse është përdorur dhe konteksti ku është përdorur togfjalëshi nga Kryetarja e Kuvendit, ka të bëjë pikërisht me një detyrim institucional, atë të nevojës për respektimin e Kodit të Etikës në Kuvendin e Shqipërisë dhe fjalia e plotë e Kryetares së Kuvendit ku ka përdorur termin "votuesit tanë" është si vijon dhe citoj: "Jo rrallë shihni në sallën e Kuvendit sjellje që nuk janë të denja, si Kryetare e Kuvendit jam vënë në një pozitë të vështirë jo përballë votuesve tanë, si pjesë e shumicës por përballë atyre që e shohin Kuvendin e Shqipërisë dhe presin të dëgjojnë aty zërin e tyre, njerëz që ngrenë zërin për komunitet e tyre, që ngrenë zërin për ligjet, që monitorojnë institucionet e me radhë". Lidhur me një tjetër citim, i ngritur nga subjekti denoncues ku është përmendur Kryeministri Rama, përsëri e sqarojmë se pjesë e fjalisë jashtë kontekstit ku janë thënë nuk pasqyrojnë saktë qëllimin e kësaj shprehje. Në kontekstin ku janë thënë fjalët më lart që citoj subjekti denoncues kanë të bëjnë pikërisht me rolin institucional të detyrimeve të Kuvendit lidhur me procesin e integritetit evropian. Ky citim ka filluar me fjalën: "Në BE nuk anëtarësohet qeveria po anëtarësohet Shqipëria" dhe ka vazhduar të flitet mbi rolet e institucionit në këtë proces dhe nevojë bashkëpunimi mes tyre. Procesi i negociatave dhe anëtarësimit drejtohet nga qeveria shqiptare, që aspiron anëtarësimin dhe konkretisht në Shqipëri është Komiteti Shtetëror për Integritetin

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Evropian është organi më i lartë që siguron bashkëpunimin, qëndrimin negociues, kryesues i këtij Komiteti është pikërisht Kryeministri i Shqipërisë. Ky funksion dhe ky kontekst ka qenë qëllimi i Kryetares së Kuvendit, kur është përmendur në diskutim për rolet e institucioneve për bashkëpunim në procesin e integritimit evropian. Ndërkohë në Kuvend punon Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian që është nga ana tjetër institucioni më i lartë këshillimor për çështjet e integritimit dhe ka pikërisht detyrë të vetën nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës nëpërmjet të gjithë forcave politike dhe aktorëve në procesin e integritimit. Gjithashtu lidhur me një citim tjetër për diskutimet e reformës në drejtësi, paketa ligjore e reformës në drejtësi është arritje institucionale e Kuvendit, është Kuvendi institucioni që ka vendimmarrje politike dhe ka vendosur në dispozicion burimet e veta si institucion që prej vendimit nr. 96/2014 për krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën e sistemit në drejtësi dhe vendimit 32/2016, për mbylljen e veprimtarisë së komisionit të posaçëm për reformën në sistemin e drejtësisë. Ka qenë puna institucionale e Kuvendit me 27 projektligje të hartuara nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, që janë shqyrtuar në Kuvend nga komisionet dhe janë miratuar pastaj me konsensus të gjithë krahëve politikë, ndaj diskutimet mbi reformën në drejtësi ne konsiderojmë pjesë e punës së Kuvendit. Lidhur me pyetjet që u bënë në seancë, pyetja e parë nëse e kam shënuar saktë ka të bëjë me të folurit në emër të qeverisë. Në fakt e kam parë vidion disa herë, edhe pjesa ku përmendet qeveria ka të bëjë me nevojën për ndryshime në skemën e sigurimeve shoqërore. Kuvendi patjetër ka një rol në çdo vendim të qeverisë sepse qeveria miraton me vendim të Këshillit të Ministrave, por asnjë ndryshim thelbësor apo reformë cilësore nuk kalon apo nuk ka efektet e tij, nuk hyn në fuqi pa kaluar në Kuvend, pa u shqyrtuar nga komisionet përkatëse, pa kaluar pastaj në seancë plenare me shumicën e votave që nevojitet dhe në këtë kuptim ne mendojmë se

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Kuvendi është legjitim, të diskutojë mbi nevojat e qytetarëve dhe reforma të caktuara, gjithashtu duhet mbajtur parasysh se iniciativa për nisma ligjvënëse nuk e ka vetëm qeveria po e kanë dhe deputetët. Gjithashtu deputetët kanë në dispozicion një sërë mjesh kontrolli ndaj qeverisë, ku mund të kërkojnë llogari dhe për mënyrën si qeveria mendon të reformojë skemën e sigurimeve shoqërore, për planet e saj, të ushtrojë presion pozitiv dhe të bëjë pikërisht misionin e tij, që nevojat e qytetarëve t'i vendosë në balancë e t'i imponojë dhe aktorëve të tjerë dhe pushteteve të tjera. Lidhur me pyetjen e dytë sesi janë njoftuar takimet, në dijeninë time me njoftimet e takimeve është marrë Shërbimi i Komunikimit, të cilët ne në një moment të dytë mund të kemi dhe një sqarim më teknik, në dijeninë time janë bërë nga Shërbimi i Komunikimit si për çdo aktivitet tjetër në grupet përkatëse që bëhen në Kuvend, qoftë me gazetarët. Po një sqarim më shterues e ka ndjekur Shërbimi i Komunikimit që është një drejtori e veçantë. Këto pak a shumë lidhur me dietat, për sa kohë është një aktivitet, për sa kohë është një aktivitet institucional i Kuvendit dhe për sa kohë ne kemi qëndrimin tonë, që është një aktivitet që ka të bëjë me punën e Kuvendit, mendoj se sipas legjislacioni përkatës, as unë nuk jam jam në dijeni çfarë janë dhënë apo jo, këto janë diçka që Shërbimi i Administrimit dhe drejtoritë që ka në varësi, i zbaton sipas legjislacionit përkatës dhe në bazë të gjithave këtyre që ne thamë më lart ne qëndrojmë si përfundim që Kuvendi është në realizim të misionit të tij si institucioni që ushtron sovranitetin e popullit dhe e ka detyrim të edukojë publikun mbi demokracinë përfaqësuese, mbi qeverisjen, të nxisë angazhimin e publikut në vendimmarrje në çdo formë. Turi “Kuvendojmë për Shqipërinë” dhe programi “Kuvendon” janë pjesë e punës dhe detyrimit të institucionit të Kuvendit dhe edukimit qytetar, bazuar si në rregulloren e Kuvendit, si në strategjinë e Kuvendit 2025 si në planin e veprimit dhe zbatimin e saj, janë aktivitete që shtrihen edhe përtej në fushatën zgjedhore, edhe përtej

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

periudhës katër mujore të raportimit. Nuk mbështesim kandidatë apo subjekte politike dhe nuk kanë pasqyruar qëllime thelbësisht elektorale, nuk kanë krijuar avantazhe elektorale në përmbajtjen e tij. Mbështetja e Kryetares së Kuvendit për rritjen e aktiviteteve të programeve të edukimit qytetar është pjesë e punës së tij si titullar institucionit dhe nuk përbën as shkelje të Kodit Zgjedhor, as nuk përbën qëllim elektoral, gjithashtu mund të shtoj ne jemi kujdesur në këtë periudhë, çdo program institucional të jetë mundësisht jashtë zonës ku Kryetarja e Kuvendit mund të ketë angazhime politike, ato janë në zona ku Kryetarja e Kuvendit në rolin e saj si politikane jashtë institucionit, as nuk kandidon, as nuk ka një angazhim organizativ politik, nuk ka sesi të krijohen qëllime elektorale për të apo për organizimin në këto qarqe që janë të ndryshme dhe të largëta nga angazhimi i Kryetares së Kuvendit si politikane. Për këtë arsye kërkojmë rrëzimin e kërkesës të subjektit denoncues dhe pushimin e hetimit administrativ. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni diçka tjetër për të sqaruar?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Po i nderuar!

Z. I. Celibashi: Shkurt ju lutem!

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Edhe njëherë insistoј tek, sigurisht që është e drejtë e çdo funksionari...Megjithatë doja të pyesja, nëse kjo iniciativa është transparente dhe gjithëpërfshirëse, pse nuk është thirrur dhe një nënkryetar tjetër i Kuvendit, pra mbi bazën e cilit faktor është bërë përzgjedhja për ta kuptuar?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Për këtë nuk kam dijeni nëse zoti Gjekmarkaj ka marrë apo jo një ftesë. Mund ta kontrollojmë në një moment të dytë.

Z. I. Celibashi: Për momentin nuk keni përgjigje?

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Madje për zëvendëskryetarin e kemi sqaruar që ka ardhur në një moment të dytë.

Z. I. Celibashi: Pyetje tjetër?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Po. Atëherë më vjen keq që disa prej deklaratave, u pretendua që ne kemi nxjerrë deklarata jashtë kontekstit, megjithatë kërkoj nga shërbimi i KQZ-së që mund t’i zbardhë të gjithë deklaratat, në fakt është e provuar që Kryetarja e, pra qëllimi zgjedhor i vënies në dispozicion të burimeve publike provohet në këtë rast, pse? Kemi transferim të fondeve të Kuvendit...

Z. I. Celibashi: Ndjesë që po ju ndërpres, kemi ndonjë pyetje për, se do ta keni fjalën për të....

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo i nderuar, thjesht, pyetje të tjera shtesë jo, vetëm...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Komentet dhe vlerësimet mbi atë çfarë tha përfaqësuesi i Kuvendit i bëni më vonë. Nuk keni nevojë për të sqaruar diçka tjetër më shumë për momentin?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të institucioneve të tjera që janë të denoncuara, bashkitë respektive, kë kishim? Bashkia e Peqinit dhe tjetër? Vetëm Bashkia e Peqinit ka ardhur. Të lutem, Bashkia Peqin paraprakisht ka bërë depozitim të pretendimeve?

Znj. P. Doçaj: Ka depozituar dhe pretendimet.

Z. I. Celibashi: Emër, mbiemër ju lutem!

Z. J. Manahasa, përfaqësues i Bashkisë Peqin: Julian Manahasa, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Peqin, përfaqësues me autorizim nga kryetari i bashkisë. Duke qenë dakord me gjithë qëndrimin që mbajti përfaqësuesi i Kuvendit, ne duam të theksojmë vetëm disa gjëra që mendojmë që do të ishin të rëndësishme dhe mendojmë që ne nuk duhet të ishim pjesë e këtij shqyrtimi administrativ. Pretendohet që ne kemi vendosur në dispozicion burime njerëzore që janë nxënësit e shkollës “Zihni Magani” të qytetit Peqin, në dispozicion të aktivitetit publik të miratuar, që ka zhvilluar Kryetarja e Kuvendit. Theksojmë faktin që nuk janë pjesë apo nomenklaturë e Bashkisë Peqin arsimit parauniversitar, theksojmë që është arsimit parashkollor, nuk kemi asnjë lloj tagri, asnjë lloj të drejte institucionale që të orientojmë, mbi veprimtarinë që do të kenë nxënësit e gjimnazeve apo të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

shkollave të mesme, nga ana tjetër nuk kemi përdorur asnjë lloj fjalimi që ka të bëjë me aktivitet politik apo propagandë politike dhe mendonim që do ishte e udhës që ky shqyrtim, të paktën në lidhje me Kryetarin e Bashkisë Peqin të pushohet sepse mendojmë që nuk duhet të pjesë e këtij shqyrtimin administrativ për këto arsye. Nuk kemi asnjë lloj tagri, asnjë lloj të drejtë që t'i përdorim këto burime njerëzore që bëhet fjalë për arsimin parauniversitar, në funksion të aktiviteteve politike. Nga ana tjetër, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Peqin nuk është përdor asnjë lloj fjalimi politik në atë lloj aktiviteti. Është një aktivitet që është miratuar nga KQZ-ja, e kemi raportuar brenda afatit ligjor, ka pasur si qëllim një vizitë në institucionin të Bashkisë Peqin, bibliotekën e qytetit dhe në gjimnazin e bashkisën Peqin, kjo ka qenë, ne kërkojmë që të pushohet procedimi.

Z. I. Celibashi: Keni ndonjë pyetje?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo nuk kemi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Për Kuvendin, po dhe ndërkohë dhe për përfaqësuesi e bashkisë, dokumentacion tjetër shtesë veç atij që deri më sot, tani keni depozituar në KQZ, keni?

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Kuvendi jo.

Z. I. Celibashi: Më duket përfaqësuesi i “Qëndresës” kishte një, në kuadër të pyetjes një kërkesë për informacion në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes së një prej nënkryetarëve të tjerë, ka patur, s’ka patur, edhe më duket sikur thatë që po do ta verifikojmë?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Mund ta verifikojmë në një moment të dytë dhe ta dërgojmë në KQZ.

Z. I. Celibashi: Dakord. Keni nevojë për këtë dokument?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo përveçse mund ta vëmë në dispozicion, ose mund ta verifikojë vetë KQZ-ja, të dhënat në Thesarin e Shtetit. Çfarë do t’i kërkonim KQZ-së është të merren autorizimet për të cilat janë bërë transfertat nëpërmjet Thesarit të Shtetit sepse është një e dhënë që ne nuk e disponojmë dhe do të kërkonim informacionin e dietave dhe shpenzimeve që janë mbuluar.

Z. I. Celibashi: Për çështjen e dietave, po mund ta sjellin dhe përfaqësuesit e Kuvendit besoj?

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Është një kërkesë që mund ta përcjellim në Shërbimin e administratës.

Z. I. Celibashi: Është informacion...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i Kuvendit: Patjetër ne kemi kërkuar informacion shtesë dhe nuk kemi marrë një përgjigje, kështu që prandaj po them që mund ta kërkojmë nëpërmjet KQZ-së.

Z. I. Celibashi: Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Mund ta ndjek personalisht këtë kërkesë, që të sigurohem që do të marrë përgjigjen e duhur.

Z. I. Celibashi: Dakord. Kushdo që merret atje, besoj do ta kemi këtë informacion nga ana juaj, pa qenë nevoja për t'ju drejtuar Thesarit të Shtetit. Mirë nëse nuk keni gjë tjetër, atëherë po e shtyjme shqyrtimin e seancës për të depozituar edhe këto dokumente të tjera dhe pastaj në vlerësim të dokumenteve shtesë fjala e fundit për ju dhe fjala e fundit për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në këtë shqyrtim administrativ. Dakord? Mirë, atëherë e mbyllim këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me denoncimin e Partisë Demokratike.

Znj. P. Doçaj: Ka të bëjë me denoncimin nr.49 të Partisë Demokratike, me subjekt të denoncuar zotin Edi Rama, objekt i denoncimit është konstatimi i kryer së veprimtarive të ndaluara, në referim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me dijeninë që kanë marrë publikisht, pasi Kryeministri Edi Rama sipas tyre ka organizuar një takim me punonjësit e administratës, sipas burimeve të ndryshme mediatike kjo ngjarje është denoncuar edhe nga shoqata administrative. Përdorimi i punonjësve të administratës shtetërore për qëllime politike përbën një veprimtari të ndaluar sipas denoncuesit. Nga ana jonë ka filluar hetimi administrativ, kemi administruar edhe pretendimet e personit përgjegjës për komunikimin në Kryeministri, të cilët theksojnë se takimi Kryeministrit me administratën publike është një veprimtari publike e raportuar në ndërfaqen NRI, brenda afateve ligjore dhe pse Kryeministri ka qenë në cilësinë e personit të ftuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Takimi nuk përbën shkelje në referim të nenit 91. Janë ftuar për ditën e sotme dhe janë prezent përfaqësuesit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike dëshiron të shtojë diçka më shumë, veçmas atyre që janë në denoncim?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Zoti Komisioner faleminderit për fjalën! Me sa mora informacion denoncimi 55 mund të ketë lidhje, pra që ka lidhje me “Qëndresën Qytetare” mund të ketë lidhje për të njëjtën temë, ndoshta jam i gabuar?

Z. I. Celibashi: Janë me objekt tjetër.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Janë me objekt tjetër.

Z. I. Celibashi: Po bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet po kërkimi i “Qëndresës” po është tjetër nga ai i juaji.

Znj. P. Doçaj: Kërkimi i “Qëndresës” ka të bëjë me mosraportimin e veprimtarisë publike ndërsa kërkimi i Partisë Demokratike me konstatimin e shkeljes së veprimtarisë.

Z. I. Celibashi: Pra ju jeni duke thënë që në këtë aktivitet janë keqpërdorura asetet publike.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: E qartë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*


Z. I. Celibashi: Kurse kërkimi i “Qëndresës” për këtë rast është tjetër gjë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Mendova se mund të shqyrtoheshin bashkërisht, këtë desha si fillim. Megjithatë ne...

Z. I. Celibashi: E bëmë paraprakisht dhe ne si mundësi po na rezultoi...Këtë radhë nuk ju bëjmë dot bashkë!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: ...në lidhje me denoncimin në fjalë ne si Parti Demokratike i qëndrojmë atyre elementëve që kemi paraqitur dhe në këtë kërkesë. Patjetër që i qëndrojmë kërkimit tonë dhe kërkujmë marrjen e masave administrative. E konsiderojmë të papranueshme përdorimin dhe keqpërdorimin e administratës publike, shtetërore, qoftë të administratës vendore të Bashkisë së Tiranës apo qoftë administratës shtetërore në përgjithësi, për zhvillimin e një aktiviteti të tillë që ndodhi para pak ditësh në sheshin “Skënderbej”, edhe pse orari ishte caktuar ora 16:30, që lë të kuptohet sikur është pas orarit zyrtar, ne aty e pamë nga pamjet filmike të bollshme të paraqitura nga të gjitha mediat dhe në të gjitha rrjetet sociale se bëhej fjalë për punonjës të administratës dhe jo vetëm por edhe për punonjës me uniformat e tyre dhe ajo ishte pjesa më domethënëse dhe më e prekshme që tregonte se potencialisht ata persona, policët me uniforma me kapele por edhe stafi besoj i pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit të Tiranës me uniformat përkatëse apo edhe personel tjetër që nuk arritëm do t’i identifikojmë përkatësinë e institucionit që ishin me uniformat e punës së tyre, prezent në atë lloj mbledhje, në atë takim në sheshin “Skënderbej”. Ne mendojmë që përbën shkelje, shkelje në këtë pikëpamje që është keqpërdorimi i administratës publike për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

aktivitet politik, zgjedhor, konsiderojeni si të doni, nuk po duam të sjellim këtu, nuk sollëm këtu raste të publikuara në rrjete sociale ku kishte dhe thirrje në grupe WhatsApp-i etj., apo të publikuara gjerësisht në media të ndryshme që bënin thirrje më herët për të shkuar, për të lënë orarin e punës pak më herët, për të shkuar për të kaluar ato kontrollet e sigurisë në një takim me Kryeministrin dhe ku praktikisht administrata vërtetohet ku të paktën, apo një pjesë e saj vërtetohet nga këto indicie që mund ta ketë lënë dhe orarin e punës më herët për të qenë aty në vendin, në orën e caktuar dhe në rreshtin e caktuar, por besojmë, i nderuar zoti Komisioner, që të gjitha këto prova që ne kemi sjellë mjaftojnë, janë të bollshme për të vërtetuar që ka pasur keqpërdorim të administratës publike nga ana e Kryeministrit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë kemi përfaqësuesin e Kryeministrit në këtë shqyrtim.

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Përshëndetje, faleminderit! Unë jam Adnor Shameti, këshilltar ligjor i Kryeministrit, është dhe akti i përfaqësimit i depozituar. I nderuar zoti Komisioner! Unë para se të paraqisja pretendimet, për atë kërkim të Partisë Demokratike që u referua më sipër, do të doja të paraqisja një kërkesë paraprake, ne e mendojmë të udhës që për ekonomi gjyqësore dhe për mënyrën sesi është paraqitur dhe kërkuar nga palë të ndryshme në lidhje me një aktivitet, është një aktivitet dhe ne çmujmë që është një objekt me disa kërkitime të ndryshme, duhet dhe do të kërkonim që nga ana juaj të bashkoheshin të gjitha kërkimet sepse nga njëra anë kemi një kërkim të organizatës “Qëndresa Qytetare” tashmë ju disponuat me vendim, u ankuan në KAS, KAS-i me vendimin nr.9 të datës 27.02.2025 ka disponuar dhe në mënyrën sesi ne e lexojmë atë vendim të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

KAS-it është një kthim për rishqyrtim edhe për hetim më të thelluar nga ana juaj në lidhje me atë kërkim. Kërkojmë që nga ana juaj dy kërkimet ai me nr. 49 i datës 21.02.2025 të Partisë Demokratike dhe kërkitimi tjetër apo denoncimi nr. 55, datë 28.02.2025 i organizatës “Qëndresa” sikurse dhe aktet që dalin nga vendimi që referova më sipër i KAS-it të bashkohen në një të vetëm, nëse ju, në cilësinë e Komisionerit të Zgjedhjeve do të bashkonit këtu ose të bënit që të shtyhej seanca dhe të bënit paraprakisht një hetim të thelluar nisur dhe nga vendimi i KAS-it që referova dhe kemi të bëjmë me një aktivitet, kërkime të ndryshme të cilat mund të ndryshme, të cilat përmblihen në një vendimmarrje për të mos u hallakatur në shqyrtimin e gjësë, do ta vlerësoja shumë nga ana juaj. Nga ana tjetër ne ato pretendimet tona i kemi depozituar pranë administratës tuaj dhe e lëmë në çmimin tuaj mënyrën e procedimit, pra të shprehemi në radhë të parë në bashkimin e të tre çështjeve apo kërkesave dhe më tej për procedimin përfundimtar në lidhje me kërkimet. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po edhe përfaqësuesi i “Qëndresës”.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: I nderuar, në këndvështrimin tonë këto çështje nuk mund të bashkohen për shkak të objektit të ndryshëm të tyre, nga njëra anë qendra “Qëndresa Qytetare” pretendon një shkelje sipas nenit 92, ndërkohë që Partia Demokratike pretendon një shkelje sipas nenit 91. Janë dy kërkime që do të rrëzojnë njëra-tjetrën në mënyrë automatike sepse aplikimi i njërës nën, përjashton zbatimin e nenit tjetër, kështu që nuk mund të kemi në këndvështrimin tonë bashkim të çështjeve, ndërkohë që pastaj shprehemi për çështjen e themelit për arsye të pretendimeve.

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po dhe unë në fakt vlerësoj se janë dy, edhe pse bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet por janë dy kërkime të që mundet të qëndrojnë dhe të dyja kërkimet, mundet të mos qëndrojnë, të dyja mund të qëndrojnë, mund të mos qëndrojnë njëri, mund të mos qëndrojnë tjetri. Kërkimi që ka të bëjë me zhvillimin ose mos zhvillimin e aktivitetit, jo domosdoshmërisht është i lidhur me mënyrën sesi zhvillohet aktiviteti, ai që e pretendon Partia Demokratike. Ai diskutimi dhe kërkesa juaj qëndron në lidhje me atë nëse do të duhej apo nuk do të duhej të ishte zhvilluar ai aktivitet, do duhej apo nuk do të duhet të ishte ndaluar nga Komisioneri, ky është një diskutim tjetër. Pra aktiviteti mund të zhvillohet po pastaj është tjetër gjë sesi zhvillohet ky aktiviteti dhe ekzistojnë elementët që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e aseteve publike e të tjera si këto, ndaj mendoj që vlerësimi im është që nuk është rasti për t'i bashkuar këto dy kërkime dhe do të ngelemi tek shqyrtimi i pretendimit të Partisë Demokratike për keqpërdorim të aseteve publike gjatë zhvillimit të atij aktiviteti dhe diskutimi në lidhje me atë se ky aktivitet do të duhet të ishte ndaluar apo jo është një çështje tjetër, është një diskutim tjetër. Që të bashkohet me këtë kërkim të organizatës "Qëndresa Qytetare" apo jo edhe në procesin e zhvilluar më parë në lidhje me këtë çështje, kështu që do të vazhdojmë t'i ngelemi vetëm shqyrtimit të pretendimeve të Partisë Demokratike në lidhje me përmbajtjen e këtij aktiviteti, veçmas atyre edhe duke vazhduar tani me shqyrtimin. Veçmas atyre që keni paraashtruar me shkrim, keni diçka tjetër për të shtuar? Nuk keni diçka tjetër për të shtuar. Dokumentacion shtesë në lidhje me këtë, palët, qoftë Partia Demokratike, qoftë përfaqësuesit e Kryeministrit për këtë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo nuk kemi dokumentacion shtesë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Dakord. Mirë, atëherë e përfundojmë këtu shqyrtimin administrativ. Përfundimisht përfaqësuesi i Partisë Demokratike i qëndron kërkimit sipas objektit?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po, i qëndrojmë kërkimit sipas objektit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e Kryeministrit?

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Rrëzimin, përse kemi parashtruar.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë mbyllim hetimin administrativ të kësaj çështje dhe vendimmarrjen do ta shpallim tjetër. Faleminderit. Atëherë kalojmë tek denoncimi tjetër i organizatës “Qëndresa Qytetare”, denoncimi nr.55. Po Pavlina, vazhdojmë me relatimin.

Znj. P. Doçaj: Ashtu sikundër dhe përmend, denoncuesi është “Qëndresa Qytetare”, subjekt i denoncuar zoti Edi Rama dhe zoti Engjëll Agaçi, objekt i denoncimit mosraportimi i veprimtarisë publike, takim me punonjësit e bashkisë. Sjellim në vëmendje që për këtë kërkesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është shprehur me një vendim, me vendimin e datës 20.02.2025, me nr.129, vendim i cili është ankimuar në KAS, vendimmarrja e KAS-it ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 20.02.2025 dhe gjithashtu është lënë me afat ankimimi, pra mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Tiranës, brenda 45 ditëve. Kjo për sa i përket pjesës procedurale të asaj që ka ndjekur kërkesa e parë e depozituar nga “Qëndresa Qytetare”.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Në lidhje me këtë kërkim, ketë objekt i këtij kërkitimi, përfaqësuesi i “Qëndresës”?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”?: I nderuar, siç jeni në dijëni Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në bazë të ankimit të qendrës “Qëndresa Qytetare” ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke argumentuar se kemi të bëjmë me zhvillimin e dy aktiviteteve të ndryshme, një aktivitet për të cilin Komisioneri Shtetëror është shprehur ishte një aktivitet i raportuar që rezultonte elektronikisht, ndërkohë që aktiviteti për të cilin qendra “Qëndresa Qytetare” kishte bërë ankim, ishte një aktivitet i ndryshëm që nuk ishte përfshirë fare në vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, edhe sikundër e tha dhe përfaqësuesi i Kryeministrit, këshilltari ligjor, ky vendim në fakt përbën një rikthim të çështjes në një farë mënyrë në shkallë të parë, para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Fakti që përfaqësuesit e KQZ-së përmendën që këtu ka një të drejtë ankimi, sigurisht e drejta e ankimit është e drejtë kushtetuese s’e mohon dot KAS-i, po fakti që kemi të bëjmë me një rikthim të vendimmarrjes është shumë e rëndësishme kjo gjë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk vendos dot në asnjë moment, në asnjë rrethanë pezullimin e ekzekutimi të të vendimit të KAS-it sepse pezullimi i aktit administrativ, siç është vendimi e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve janë të ekzekutueshme menjëherë nga momenti që ato hyjnë në fuqi, me përjashtim të rasteve nëse ka vendim gjyqësor që thotë marrjen e masës së sigurimit apo vendimin gjyqësor që është pezulluar dhe në referim të nenit 180 të Kodit të Procedurës Administrative që parashikon në mënyrë taksative rastet se cilat janë pezullimi. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një rikthim të çështjes, pra është çështja, dihet kemi një veprimtari të Kryeministrit që është zhvilluar në mënyrë të paraportuar nga ana e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Kryeministrisë, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka deklaruar që kemi dy veprimtari krejtësisht të ndryshme dhe i ka lënë detyrë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të propozojë sanksione sepse tashmë hetimi administrativ është kryer në një shkallë më të lartë se Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve, duke konstatuar vetë shkelje që kemi të bëjmë me një zhvillim një veprimtari që nuk është raportuar në asnjë moment. Kështu që në përfundim të këtij shqyrtimi do t'i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si e vetmja mundësi ligjore që ai ka, duke iu referuar nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative që përcakton në mënyrë taksative se ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë subjekti ekzekutiv kur vërtetohet rreziku se shkakton një dëm të madh i konsiderueshëm, që nuk kemi të bëjmë në këtë rast se nuk kemi ndonjë shembje objekti ose raste të tilla, kur gjykata ka vendosur sigurimin e padisë apo ekzekutimi mund të shkaktojë vepra penale etj., etj. Kështu që në këndvështrimin tonë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në lidhje me denoncimin fillestar që ka bërë "Qëndresa Qytetare" duhet të vendosë, më saktë duhet të konstatojë njësoj si KAS-i që kemi të bëjmë me një veprimtari të paraportuar dhe zhvillimin e saj dhe për rrjedhojë duhet të merren sanksion administrativ ndaj Kryeministrit Edi Rama si subjekti që ka penguar raportimin e kësaj veprimtarie dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, zotit Engjëll Agaçi si personi përgjegjës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Kryeministrit.

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrisë: Faleminderit! Sikurse parashtrova më parë, duke qenë që ju disponuat me të drejtë që të veçohet vetëm ai, pjesa e kërimit apo ankimit të subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë". Në rastin e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

vendimit të KAS-it të referuar si nga ana jonë ashtu dhe nga përfaqësuesit e organizatës “Qëndresa”, sikurse dhe ankimi që po shqyrtojmë tani, ne i qëndrojmë atyre kërtimeve dhe pretendimeve të paraqitura që në seancën e parë që ju me të drejtë, në cilësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e keni vendosur rrëzimin e kërkesës dhe i tillë duhet të jetë dhe vendimi i sotshëm, në bashkim të këtyre kërtimeve që thotë shqyrtojmë por njëherësh dhe të atij hetimit të thelluar po themi që përmban gjuha e vendimit të KAS-it për prishjen e vendimit tuaj origjinal. Kështu që në përfundim të analizës dhe të gjykimit dhe të shqyrtimit të thelluar nga ana juaj, si detyrim i vendimit paraprak të KAS-it, ashtu edhe i analizës së detajuar të kërtimeve në këtë ankim ku ne i kemi dorëzuar me shkrim pretendimet tona, kërkojmë që përfundimisht t’i vihet kapak njëherë e mirë kësaj çështje duke u vendosur rrëzimi i kërtimeve si në rastin e parë dhe në rastin e dytë paraqitur nga ana e kërkuësve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po besoj që ne do të vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj çështje, pra është e qartë që tani bëhet fjalë për dy kërtime të ndryshme, kërkitimi juaj me kërkitimin që kishte Partia Demokratike dhe njëri ka të bëjë atë se do duhej apo jo të zhvillohej ky aktivitet dhe kërkitimi i Partisë Demokratike kishte të bënte me përmbajtjen e këtij aktiviteti dhe në referim të asaj çfarë secila prej palëve prezantoi këtu në lidhje me vendimmarrjen e KAS-it. Pyetja që kam unë, keni dokumentacion tjetër shtesë që, qoftë pala denoncuese, për të depozituar?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo i nderuar!

Z. I. Celibashi: Jo. Mirë. Faleminderit! Do të administrojmë atë dokumentacion që është tashmë i depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

konsiderojmë të mbyllur hetimin administrativ për këtë çështje. Pretendimet tuaja të fundit dhe pretendimet e palës tjetër.

Z. Dh. Zguro, përfaqësuesi “Qëndresës Qytetare”: Atëherë pretendimet tona të fundit janë, duke cituar vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, vendimin nr. 7, në mos gabohem “Të gjitha të dhënat e ndryshme janë përcaktuese për ta cilësuar veprimtarinë të ndryshme dhe identike me veprimtarinë e raportuar si ceremonia e hapjes “Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut”, fakti është se kjo veprimtari është e paraportuar, ndaj për sa më sipër KAS gjykon se rruga e vetme e drejtë është shfuqizimi i vendimit të Komisionerit sepse palët kështu kthehen në pozitën juridike fillestare dhe mundësinë që të orientojnë qëndrimin e tyre, këtë radhë nga pozicione të ligjshme si dhe tashmë është hetimi administrativ pranë KSHZ-s-, ai që duhet të përcaktojë se cili ishte organi publik që duhet ta raportonte këtë aktivitet dhe përcaktohet dhe sanksioni përkatës për këta persona”. Hetimi administrativ në këndvështrimin tonë është i mbyllur, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vetëm pranimin le të themi ose më saktë, kërkimin pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për vendosjen e sanksionit ndaj Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë si person që ka penguar raportimin e këtij aktiviteti duke lajmëruar zhvillimin e tij vetëm një ditë më përpara dhe në të njëjtën kohë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm për lejin e zhvillimit të një veprimtarie të paraportuar. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Kryeministrit.

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Përfundimisht kërkojmë që nga ana juaj të rikonfirmohet vendimi i parë, pra i juaji si i drejtë, i bazuar në ligj dhe në

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

provat e administruara nga njëra anë dhe rrëzimin e kërimit të ri, të paraqitur nga organizata “Qëndresa Qytetare”. Nën frymën e analizës së thelluar nga ana juaj të të gjithë pretendimeve dhe akteve të administruara edhe në optikën e vendimit referuar të KAS-it, përfundimisht ky vendim përmbledhës, gjithëpërfshirës i cili konfirmon qëndrimin tuaj paraprak nga njëra anë dhe rrëzimin e të dy kërtimeve të paraqitura nga organizata “Qëndresa Qytetare”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, atëherë për shpalljen e vendimit do të njoftoheni një ditë tjetër.

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Ka mundësi që të bëhet një spostim në çështjet në rendin e ditës që të përfundojmë edhe me kërkesën 23, denoncimin 23, nëse është e mundur?

Z. I. Celibashi: Nuk besoj se ka ndonjë problem, edhe nga palët, 23 është denoncimi i Partisë Demokratike? Nga çështjet e mbartura?

Znj. P. Doçaj: Po, nga çështjet e mbartura. Ka të bëjë me pretendimin në lidhje me akreditimin në sektorin e bujqësisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Kryeministri ka deklaruar se nëpërmjet një bashkëpunimi midis Bankës Qendrore do të ketë një financim për garancinë sovranë ku do të mbulohet 70% e principalit të kredisë që do të aplikohet nga fermerët dhe sipërmarrësit në sektorin e bujqësisë.

Z. I. Celibashi: Po, keni diçka më shumë për të shtuar, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Ne i qëndrojmë atyre elementëve që kemi paraqitur i nderuar zoti Komisioner! Mendojmë se Kryeministri me këtë propozim konkret që ka bërë në media, në ditën e caktuar, sikundër e kemi paraqitur, ka shkelur pikërisht rregullin që katër muaj para zgjedhjeve nuk mund të propozohen akte ligjore ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, si dhe akte që parashikojnë mbështetjen ekonomike në sektor të caktuar dhe në zbatim të, po themi të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, ne mendojmë që duhen marrë masat për ta ndaluar një gjë të tillë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësues të Kryeministrit?

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Po faleminderit! Përfundimisht pas analizës dhe shqyrtimit të pretendimeve të përfaqësuesit të Partisë Demokratike ne jemi për rrëzimin e kërimit dhe të këtij denoncimi, i cili nuk përmban asnjë nga ato kriteret e kushte ligjore që parashikon Kodi, kështu që duhet të rrëzohet kërkesa. Faleminderit! Me shkrim jua kemi paraqitur të detajuar të gjitha pretendimet, kështu që nuk ka pse ta përsëris.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dokumentacion shtesë veç atij që është paraqitur deri më tani nuk keni? Nga secila prej palëve nuk kemi? Mirë. Faleminderit! E mbyllim edhe për këtë denoncim hetimin administrativ, përfundimisht pala denoncuese kërkon që t'i qëndrojë pretendimeve?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po i kërkojmë Komisionerit Shtetëror t'i qëndrojë, pra të pranohet kërkesa sipas objektit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Kryeministrit?

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Përfundimisht kërkojmë rrëzimin e kërkesës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë për shpalljen e vendimit do të njoftoheni në vijim, për ditën, datën e shpalljes së këtij vendimi. Përfundojmë edhe me këtë denoncim. Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimit nr. 12 të regjistrit të denoncimeve, bërë nga Instituti i Studimeve Politike.

Znj. P. Doçaj: Subjekti i denoncuar është zonja Elisa Spiropali, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë dhe zoti Genc Gjonçaj në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me njoftimin në kuadër të programit “Kuvendon”, do të ketë një takim dhe diskutim me studentët e Universitetit “Ismail Qemali” dhe takime me qytetarë në Bashkinë Vlorë dhe takime me të rinj në gjimnazin e Bashkisë Himarë. Është zhvilluar hetimi administrativ dhe në datën 25.02.2025 është zhvilluar seanca publike ku janë administruar prova por rezulton që menjëherë pas seancës nga Instituti i Studimeve Politike kanë depozituar një provë të re dhe ne për këtë motiv mendojmë se duhet të riçelimi hetimin administrativ që të administrojmë edhe provën e depozituar nga denoncuesit.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë do ta riçelimi hetimin administrativ, do të bëjmë administrimin e dokumentacionit shtesë të paraqitur nga Instituti i Studimeve Politike, si denoncues në këtë rast. Nuk e di nëse përfaqësues të Kuvendit që janë prezent dhe janë njohur dhe besoj duan të njihen me këtë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Kërkojmë kohë që të njihemi me këtë.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Institutit? Emër, mbiemër ju lutem.

Znj. J. Bilbilaj, përfaqësuese e ISP: Juljana Bilbilaj nga Instituti i Studimeve Politike.

Z. I. Celibashi: Keni diçka më shumë për të shtuar në lidhje me këtë?

Znj. J. Bilbilaj, përfaqësuese e ISP: Jo e vetmja gjë që unë dua të them është që duke qenë se dhe objekt i denoncimit është i ngjashëm pjesërisht me objektin e një denoncimi të mëparshëm do të kërkonim bashkimin e çështjes dhe gjithashtu ajo që kemi kërkuar në të dy rastet është shpërdorimi i burimeve, domethënë të merret në shqyrtim bashkë me “Qëndresën”.

Z. I. Celibashi: Është bashkë, është e njëjta çështje?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Po i nderuar është e njëjta çështje, i njëjti objekt. Denoncimi ynë karakteristikë ka se ne pretendojmë dy aktivitete të tjera janë në kuadër të së njëjtës iniciativë.

Z. I. Celibashi: Dakord. Unë mendoj që edhe në këtë rast nuk mund të vendosim bashkimin sepse edhe pse janë të një natyre si aktivitete mund të rezultojë që njëri të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit e tjetri jo sepse janë zhvilluar në dy, si të thuash ambiente të ndryshme, në dy territore të ndryshme. Ai çfarë shqyrtuam

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

pak më përpara kishte veç Kuvendit edhe disa subjekte të tjera, kurse rasti i Institutit lidhet vetëm me Kuvendin, edhe mund të qëllojë që...

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: E kuptoj thjesht në këndvështrimin tonë do të ishte, sepse bëhet fjalë për të njëjtën nismë.

Z. I. Celibashi: Po, është e njëjta gjë, po diku ajo mund të jetë e respektuar, domethënë qasja e Kuvendit, po ose jo, diku dhe mund të ketë pretendime të ndryshme. Mund të rezultojë që të vendoset në të dyja rastet njësoj po mund të rezultojë që të vendoset edhe ndryshe, kështu që do të vazhdojmë me secilin prej denoncimeve, me shqyrtim të veçantë. Keni gjë tjetër për të thënë?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Jo.

Z. I. Celibashi: Atëherë keni nevojë për të marrë kohë për t’u konsultuar me atë dokumentacionin shtesë, të paraqitur?

Z. G. Mebelli, përfaqësues i Kuvendit: Po kemi nevojë të njihemi me dokumentin e depozituar.

Z. I. Celibashi: Është zbardhje e një regjistrimi më duket të fjalës në atë aktivitet apo jo?

Znj. J. Bilbilaj, përfaqësuese e ISP: Është fjala e Kryetares së Kuvendit në takimin e Vlorës, zbardhja e minutave, prezantimi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Dakord. Mirë, atëherë po e shtyjmë këtë përsëri, do t'ju njoftojmë me siguri, ndoshta të martën do të jetë seanca për këtë çështje. Kalojmë tek shqyrtimi i denoncimit me nr. 22 të Partisë Demokratike.

Znj. P. Doçaj: Po subjekt i denoncuar në këtë rast është zoti Pjerin Ndreu, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Lezhë. Pretendimi ka të bëjë me marrjen dijani se Bashkia Lezhë ka shpallur një procedurë prokurimi për sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve rurale. Seanca publike është zhvilluar në datë 25.02.25 dhe është shtyrë për vazhduar hetimin administrativ dhe administrimin e disa provave të cilat janë paraqitur nga Bashkia Lezhë, prapësimet e tyre dhe gjithashtu dhe vendimin konkret të datës 19.12.2024 të këshillit bashkiak ku na vendosi në dispozicion sesi janë përfituar fondet për zhvillimin e këtij burimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike do të shtojë diçka më shumë, veçmas sa keni materialin e denoncues?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo i nderuar, i qëndrojmë pretendimeve tona dhe vlerësojmë që kemi dhe në këtë rast shkelje sepse kemi të bëjmë me rrugë të cilat janë në kompetencë të bashkisë dhe jemi prag, në atë kuadër që përsëritet edhe pas shumë vitesh, ku më përpara bëheshin ato inagurimet elektorale, asfalti elektoral, tashmë ka ndryshuar pak metodologjia, por jemi prapë tek e njëjta gjë, serviret puna në rrugë dhe në shtrimin apo asfaltimin e rrugëve, pikërisht në javët dhe muajt para zgjedhjeve për të përfituar elektoralisht dhe politikisht. Ne mendojmë që këto aktivitete duhet të jenë të ndaluara dhe mendojmë që bëjnë pjesë njëherë tek aktivitetet e ndaluara sipas aktit rregullator përkatës dhe gjykojmë që duhet të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

jenë të ndaluara. Për sa kohë janë zhvilluar, në kundërshtim me këto udhëzime kërkojmë marrjen e masave nga ana e KQZ-së. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi përfaqësues të Bashkisë Lezhë? Nuk kemi. Ndërkohë i kanë paraqitur me shkrim?

Znj. P. Doçaj: I kanë paraqitur me shkrim pretendimet, bashkëlidhur edhe vendimin.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike është njohur me këtë parashtrim? Do t'jua vëmë në dispozicion.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po mund të na i vini në dispozicion po ato kanë ardhur në rrugë elektronike gjithsesi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëherë e përfundojmë hetimin administrativ edhe për këtë çështje dhe shpalljen e vendimit do ta njoftojmë për një ditë tjetër. Kalojmë tek shqyrtimi i denocimit nr.28, po të Partisë Demokratike.

Znj. P. Doçaj: Edhe në këtë rast është një rast i ngjashëm po subjekti i denoncuar është Vangjel Tavo në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Himarë, ka të bëjë dhe këtu me rikonstrukcion të rrugëve Horë-Vranisht dhe pala denoncuese denoncon se janë prokurime publike të cilat bien në kundërshtim me ligjin. Në seancën e datës 25.02.25 është lënë kohë Bashkisë Himarë për të paraqitur prova dhe ka paraqitur prapësimet nëpërmjet emailit dhe gjithashtu dhe vendimin e këshillit bashkiak me nr. 42, datë 20.12.2024 ku provon dhe dhënien e fondeve përpara fillimit të afatit të

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

11 janarit sipas tyre. Janë administruar nga ana jonë dhe i është dërguar me email edhe denoncuesit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po dhe për rastin e Bashkisë Himarë është pak a shumë e njëjta tipologji me denoncimin e mëparshëm lidhur me Bashkinë e Lezhës dhe gjykojmë që edhe në këtë rast për sa kohë kemi të bëjmë me përdorim të aseteve publike në këtë rast, rrugës e cila është një rrugë e administruar dhe që e ka kompetencë për ta mirëmbajtur bashkia përkatëse, pra Bashkia Himarë, për sa kohë është një rikonstruksion apo një asfaltim, më thjeshtë një rrugë pak javë apo pak muaj para zgjedhjeve, gjithsesi brenda periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve, ne mendojmë që është një aktivitet i ndaluar dhe duhet të merren masat administrative përkatëse. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi përfaqësues të Bashkisë Himarë? Jo. Jeni njohur me parashtrimet, përfaqësuesi i Partisë Demokratike, të Bashkisë Himarë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po jemi njohur nëpërmjet emailit na janë përcjellë.

Z. I. Celibashi: Mirë, përfundojmë hetimin administrativ edhe të kësaj çështje dhe shpalljen e vendimit do ta njoftojmë një ditë tjetër. Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit nr.24 të KRIIK.

Znj. P. Doçaj: Po dhe në këtë rast është një çështje e mbartur, ka të bëjë me subjektin e denoncuar, zonjën Zhaneta Beqiri, në cilësinë e Drejtorit të

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025**

Përgjithshëm të Administrimit të Kopshteve dhe Çerdheve, objekt i denoncimit ka të bëjë me inagurimi e një kopshti, kopshtit nr. 74, “Luleborë”, në datën 25.02.25 në zhvillimin e seancës publike është shtyrë për të administruar prova nga ana e Drejtorisë së Kopshteve dhe Çerdheve, janë administruar me email dhe ka të bëjë me ftesën ku Bashkia Tiranë ka zhvilluar këtë si veprimtari publike. Pra pretendimi i drejtoreshës të Kopshteve dhe Çerdheve thekson se ka qenë në cilësinë e të ftuarës dhe na ka bërë me dije pikërisht këtë ftesë të depozituar me email. Është prezent përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë edhe Kopshteve dhe Çerdheve.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Vetëm emrin ju lutem dhe në çfarë cilësie jeni këtu?

Znj. I. Lame, përfaqësuese e Drejtorisë së Çerdheve dhe Kopshteve: Ivona Lame, Drejtore Juridike e Drejtorisë së Çerdheve dhe Kopshteve. Sikurse kemi bërë me dije edhe në prapësimet që kemi dërguar dhe në provat që kemi dërguar, në këtë aktivitet, ashtu si në aktivitetet e tjera për inagurimin e çerdheve dhe kopshteve, titullari i institucionit tonë është në cilësinë e të ftuarit. Kemi vënë në dispozicion edhe ftesën e cila ka mbërritur me email, për aktivitetin që do të zhvillohet, në ftesë përcaktohet se ne event do të jetë e ftuar Drejtoresha e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, zonja Zhaneta Beqiri. Në këtë kuadër ne kemi bërë raportimin pasi Drejtoresha e Kopshteve dhe Çerdheve do të mbante fjalim në këtë inagurim dhe vetëm në këtë cilësi. Për sa i përket ankesës së Koalicionit KRIIK ku thuhet përse nuk kemi raportuar për fjalën që kanë mbajtur dy deputetët, sikurse thamë ne jemi të ftuar në këtë event dhe kemi koordinuar punën vetëm për sa i përket shërbimit në çerdhe dhe kopshte në orarin që do të ishte inagurimi, për këtë arsye nuk kemi raportuar dy deputetët që do të mbanin fjalën.

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Keni dokumentacion për të paraqitur shtesë, veç çfarë ne disponojmë?

Znj. I. Lame, përfaqësuese e Drejtorisë së Çerdheve dhe Kopshteve: Vetëm ato që kemi dërguar.

Z. I. Celibashi: Dakord. Faleminderit! Atëherë edhe për këtë shqyrtim administrativ përfundojmë hetimin e tij dhe për shpalljen e vendimit do të njoftoheni një ditë tjetër. Faleminderit! Kishit diçka tjetër? Jo. Përfaqësuesja e bashkisë?

Znj. L. Troja, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Për ne nuk ka ardhur një ankim që ne të paraqisnim pretendimet tona me shkrim. Po themi që është bërë ky aktivitet në të mirë të, gjithmonë në interesa publike, në mënyrë që çerdhet dhe kopshtet janë të domosdoshme në këtë qytet. Rastisi që ky ishte një projekt që është bërë më përpara dhe investimet kanë qenë më përpara, momenti qëllloi në këtë datë që të inagurohej, nuk është se u bë tani, është marrë një vendim i këshillit teknik, që është aprovuar dhe janë siguruar fondet që është bërë edhe inagurimi i këtij kopshti në shërbim të komunitetit.

Z. I. Celibashi: Qartë, edhe ata të organizatës pretendojnë pse është bërë kopshti dhe çfarë shërben kopshti

Znj. L. Troja, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Tani ky është pretendimi ynë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 7.03.2025*

Z. I. Celibashi: Jo, jo, nuk ka njeri diskutim për këtë gjë, për dobinë e ndërtimit të kopshteve. Keni gjë tjetër?

Znj. L. Troja, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Jo. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Nuk keni? Mirë. Faleminderit! Atëherë shpallja e vendimit një ditë tjetër, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

